



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:261092

Datë: 28.06.2024

Numri i dokumentit: 05874436

KPPP.nr.2024/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit “IP-KOS” SH.P.K., me numër të regjistrimit të biznesit 71017729, me seli në Prishtinë, rr. “Pennsylvania” nr. 41 (Marigona Residence), kundër debitorit “Tijani Company” SH.P.K., me NUI: 811411701, me seli në Prizren, rr. “Landovicë”, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.1851/23 të datës 08.11.2023, të Përmbartuesit Privat Isa Gacaferi me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 28.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit “Tijani Company” SH.P.K., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.1851/23 i datës 08.11.2023, i Përmbartuesit Privat Isa Gacaferi.
- II. MBETET në fuqi Urdhri Përmbartimor P.nr.1851/23 i datës 08.11.2023 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Isa Gacaferi.
- III. URDHËROHET debitori “Tijani Company” SH.P.K., që në rast të parashtrimit ankesës, të deponoj në llogari të veçantë të “Këshillit Gjyqësor të Kosovës” nëpërmjet arkës së Gjykatës Themelore në Prishtinë, garancionin në shumën prej 25,383.98 € (njëzet e pesë mijë e tre qind e tetëdhjetë e tre euro e nëntëdhjetë e tetë cent), në afat prej 7 (shtatë) ditëve, nga dita e pranimi të këtij aktvendimi.
- IV. Nëse debitori nuk e deponon garancionin brenda afatit të caktuar, ankesa e ushtruar kundër këtij aktvendimi, do të konsiderohet se nuk është dorëzuar fare nga pala ankuese.

A r s y e t i m

Përmbaresi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “IP-KOS” SH.P.K., ka lëshuar urdhrin përmbarimor P.nr.1851/23 të datës 08.11.2023, me të cilin ka lejuar përmbarimin, në bazë të dokumentit të besueshëm: Faturës Nr. 594-34/2023 të datës 02.06.2023; Faturës Nr. 026-21-01-115660 të datës 01.07.2023; Faturës Nr. 026-21-01-115661 të datës 01.07.2023; Faturës Nr. 026-21-01-115662 të datës 01.07.2023; Faturës Nr. 026-21-01-115663 të datës 01.07.2023; Faturës Nr. 026-21-01-115665 të datës 01.07.2023; Faturës Nr. 026-21-01-115666 të datës 01.07.2023; Faturës Nr. 026-21-01-115667 të datës 01.07.2023; Faturës Nr. 026-21-01-115668 të datës 01.07.2023; Faturës Nr. 026-21-01-115669 të datës 01.07.2023; Faturës Nr. 026-21-01-115670 të datës 01.07.2023; Faturës Nr. 026-21-01-115671 të datës 01.07.2023; Faturës Nr. 026-21-01-115672 të datës 01.07.2023; Faturës Nr. 026-21-01-115673 të datës 01.07.2023; Faturës Nr. 026-21-01-115691 të datës 02.07.2023; Faturës Nr. 026-21-01-115693 të datës 02.07.2023; Faturës Nr. 026-21-01-115698 të datës 03.07.2023; Faturës Nr. 026-21-01-115699 të datës 03.07.2023; Faturës Nr. 026-21-01-115723 të datës 04.07.2023; Faturës Nr. 026-21-01-115729 të datës 04.07.2023; Faturës Nr. 026-21-01-115743 të datës 05.07.2023; Faturës Nr. 026-21-01-115747 të datës 05.07.2023; Faturës Nr. 026-21-01-115748 të datës 05.07.2023; Faturës Nr. 026-21-01-115759 të datës 06.07.2023; Faturës Nr. 026-21-01-115760 të datës 06.07.2023; Faturës Nr. 026-21-01-115788 të datës 07.07.2023; Faturës Nr. 026-21-01-115814 të datës 08.07.2023; Faturës Nr. 026-21-01-115815 të datës 08.07.2023; Faturës Nr. 026-21-01-115822 të datës 08.07.2023; Faturës Nr. 026-21-01-115834 të datës 09.07.2023; Faturës Nr. 026-21-01-115837 të datës 09.07.2023; Faturës Nr. 026-21-01-115841 të datës 10.07.2023; Faturës Nr. 026-21-01-115845 të datës 10.07.2023; Faturës Nr. 026-21-01-115857 të datës 11.07.2023; Faturës Nr. 026-21-01-115858 të datës 11.07.2023; Faturës Nr. 026-21-01-115866 të datës 11.07.2023; Faturës Nr. 026-21-01-115878 të datës 12.07.2023; Faturës Nr. 026-21-01-115882 të datës 12.07.2023; Faturës Nr. 026-21-01-115888 të datës 12.07.2023; Faturës Nr. 026-21-01-115893 të datës 12.07.2023; Faturës Nr. 026-21-01-115895 të datës 12.07.2023; Faturës Nr. 026-21-01-115932 të datës 14.07.2023; Faturës Nr. 026-21-01-115945 të datës 15.07.2023; Faturës Nr. 026-21-01-115951 të datës 15.07.2023; Faturës Nr. 026-21-01-115968 të datës 16.07.2023; Faturës Nr. 026-21-01-115969 të datës 16.07.2023; Faturës Nr. 026-21-01-115970 të datës 16.07.2023; Faturës Nr. 026-21-01-115971 të datës 16.07.2023; Faturës Nr. 026-21-01-115981 të datës 17.07.2023; Faturës Nr. 026-21-01-115987 të datës 17.07.2023 dhe Faturës Nr. 026-21-01-116005 të datës 18.07.2023, me të cilin është detyruar debitori që në emër të përmbushjes së obligimeve nga faturat si më sipër, brenda 7 ditësh nga data e dorëzimit të urdhrin, t’ia paguaj

kreditorit shumën prej 25,383.98 €, me kamatë ligjore, duke e llogaritur nga data kur kërkesa është bërë e arritshme, e deri në pagesën definitive, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të këtij propozimi, ashtu që të gjitha detyrimet të realizohen përmes zbatimit të përmbartimit sipas llogarive bankare të debitorit dhe bartjen e tyre në llogarinë e veçantë bankare të Zyrës Përmbartimore, ndërsa nëse debitori nuk posedon mjete monetare në llogaritë e tij bankare, zyra përmbartimore të zbatoj përmbartimin përmes sekuestrimit të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme dhe me shitjen e tyre të bëhet inkasimi i borxhit në llogari të kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbartimor, duke deklaruar se nuk është i përshtatshëm për përmbartim, sepse objekti i kredisë është i paqartë, si dhe nuk është treguar as koha kur është krijuar borxhi, e për më tepër borxhit të kërkuar sipas propozimit nuk është dhënë afati për përmbushje vullnetare. Më tutje ka shtuar se faturat e bashkëngjitura nuk janë të vulosura dhe nuk mund të merren se janë pranuar nga debitori. Ka theksuar se në rastin konkret mungon marrëveshja në mes të kreditorit dhe debitorit, që vërteton faktin se debitori në emër të kontratës i ka marrë shërbimet që i ka faturuar kreditori. Gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta aprovoj si të bazuar, si dhe të obligoj kreditorin që të paguaj shpenzimet e procedurës.

Kreditori në përgjigje në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit, duke theksuar se në nenin 4 të Kontratës së furnizimit me derivate ceket edhe afati i përmbushjes së obligimeve dhe borxhit të cilin e ka debitori. Më tutje ka shtuar se kontrata është akt i vullnetshëm dhe i lexueshëm nga ana e palëve, andaj konsiderohet se debitori e ka ditur apo është dashur të dijë se çfarë po nënshkruan. Në lidhje me kundërshtimin e debitorit se fatura nuk konsiderohet dokument i përshtatshëm për përmbartim, të njëjtat konstatime i ka konsideruar si të pabazuara, për faktin se faturat përmbajnë nënshkrimin në ditën e pranimin të shërbimit nga debitori, të njëjtat nuk janë kontestuar dhe se palët ndërgjyqëse kanë nënshkruar marrëveshje kontraktuale mbi furnizimin me derivate. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet si i pabazuar prapësimi i debitorit, të lejohet përmbartimi sipas urdhrin përmbartimor dhe të obligohet debitori që t'i bart shpenzimet e procedurës në tërësi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën

Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbartim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara dhe janë të përshtatshme për përmbartim, bazuar në dispozitat e nenit 29 par.3 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Me neni 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbartuesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm: Faturën Nr. 594-34/2023 të datës 02.06.2023; Faturën Nr. 026-21-01-115660 të datës 01.07.2023; Faturën Nr. 026-21-01-115661 të datës 01.07.2023; Faturën Nr. 026-21-01-115662 të datës 01.07.2023; Faturën Nr. 026-21-01-115663 të datës 01.07.2023; Faturën Nr. 026-21-01-115665 të datës 01.07.2023; Faturën Nr. 026-21-01-115666 të datës 01.07.2023; Faturën Nr. 026-21-01-115667 të datës 01.07.2023; Faturën Nr. 026-21-01-115668 të datës 01.07.2023; Faturën Nr. 026-21-01-115669 të datës 01.07.2023; Faturën Nr. 026-21-01-115670 të datës 01.07.2023; Faturën Nr. 026-21-01-115671 të datës 01.07.2023; Faturën Nr. 026-21-01-115672 të datës 01.07.2023; Faturën Nr. 026-21-01-115673 të datës 01.07.2023; Faturën Nr. 026-21-01-115691 të datës 02.07.2023; Faturën Nr. 026-21-01-115693 të datës 02.07.2023; Faturën Nr. 026-21-01-115698 të datës 03.07.2023; Faturën Nr. 026-21-01-115699 të datës 03.07.2023; Faturën Nr. 026-21-01-115723 të datës 04.07.2023; Faturën Nr. 026-21-01-115729 të datës 04.07.2023; Faturën Nr. 026-21-01-115743 të datës 05.07.2023; Faturën Nr. 026-21-01-115747 të datës 05.07.2023; Faturën Nr. 026-21-01-115748 të datës 05.07.2023; Faturën Nr. 026-21-01-115759 të datës 06.07.2023; Faturën Nr. 026-21-01-115760 të datës 06.07.2023; Faturën Nr. 026-21-01-115788 të datës 07.07.2023; Faturën Nr. 026-21-01-115814 të datës

08.07.2023; Faturën Nr. 026-21-01-115815 të datës 08.07.2023; Faturën Nr. 026-21-01-115822 të datës 08.07.2023; Faturën Nr. 026-21-01-115834 të datës 09.07.2023; Faturën Nr. 026-21-01-115837 të datës 09.07.2023; Faturën Nr. 026-21-01-115841 të datës 10.07.2023; Faturën Nr. 026-21-01-115845 të datës 10.07.2023; Faturën Nr. 026-21-01-115857 të datës 11.07.2023; Faturën Nr. 026-21-01-115858 të datës 11.07.2023; Faturën Nr. 026-21-01-115866 të datës 11.07.2023; Faturën Nr. 026-21-01-115878 të datës 12.07.2023; Faturën Nr. 026-21-01-115882 të datës 12.07.2023; Faturën Nr. 026-21-01-115888 të datës 12.07.2023; Faturën Nr. 026-21-01-115893 të datës 12.07.2023; Faturën Nr. 026-21-01-115895 të datës 12.07.2023; Faturën Nr. 026-21-01-115932 të datës 14.07.2023; Faturën Nr. 026-21-01-115945 të datës 15.07.2023; Faturën Nr. 026-21-01-115951 të datës 15.07.2023; Faturën Nr. 026-21-01-115968 të datës 16.07.2023; Faturën Nr. 026-21-01-115969 të datës 16.07.2023; Faturën Nr. 026-21-01-115970 të datës 16.07.2023; Faturën Nr. 026-21-01-115971 të datës 16.07.2023; Faturën Nr. 026-21-01-115981 të datës 17.07.2023; Faturën Nr. 026-21-01-115987 të datës 17.07.2023 dhe Faturën Nr. 026-21-01-116005 të datës 18.07.2023; të cilat fatura i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara mallrat të cilat kanë qenë objekt i këtyre faturave, është përcaktuar shuma e cila përben detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, koha e përmbushjes së këtij detyrimi si dhe të njëjtat janë bërë të arritshme për pagesë.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat e lartcekura i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që të njëjtat janë dorëzuar në origjinal, si dhe mbajnë nënshkrimin e pranimit nga debitori.

Gjykata vlerësoi pretendimet e debitorit për kohën e përmbushjes së detyrimit monetar dhe gjeti se e njëjta nuk gjen mbështetje ligjore, sepse në rastin konkret faturat e lartcekura i plotësojnë kushtet e përcaktuara për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, për faktin se afati i përmbushjes së detyrimit është përcaktuar në faturë. Për më tepër fatura e cila nuk përmban afat të përmbushjes nga data e lëshimit të faturës, nënkuptohet se afati për përmbushje arrin menjëherë respektivisht në datën e lëshimit të faturës.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera të debitorit, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i procedurës përmbarimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoroz, në bazë të cilit nuk

lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbartimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit si objekt përmbartimi.

Në pikën III të dispozitivit të këtij aktvendimi, gjykata ka urdhëruar debitorin që në rast të parashtrimit të ankesë kundër këtij aktvendimi, të deponoj garancinë në gjykatë, në shumën e përcaktuar si në këtë pikë të dispozitivit të këtij aktvendimi dhe gjykatës t'ia dorëzoj provën për pagesën e garancionit, konform dispozitës ligjore të nenit 78 par.2 dhe 4 të LPP-së.

Andaj bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbartimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.2024/23, datë 28.06.2024

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.